



REPUBLIKA E KOSOVËS - REPUBLIKA KOSOVA - REPUBLIC OF KOSOVO
KËSHILLI GJYQËSOR I KOSOVËS - SUDSKI SAVET KOSOVA - KOSOVO JUDICIAL COUNCIL
PANELI ZGJEDHOR PËR ANKESA DHE PARASHTRESA
IZBORNI PANEL ZA ŽALBE I PREDSTAVKE - ELECTION COMPLAINTS AND APPEALS PANEL

ZL.Anr.175/2025

Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa (PZAP), i përbërë nga gjyqtarët: Kujtim Pasuli - kryesues, Hidajete Gashi Alaj dhe Ramush Bradiqi - anëtarë, duke vendosur përkitazi me ankesën e subjektit politik Lëvizja Vetëvendosje (LVV), me seli në Prishtinë, të paraqitur kundër subjektit politik Lidhja Demokratike e Kosovës (LDK), për shkak të shkeljes së Kodit të Mirësjelljes për Subjektet Politike, Mbështetësit e tyre dhe Kandidatët, gjatë Fushatës Zgjedhore për Zgjedhjet Lokale në Republikën e Kosovës, në seancën e panelit të mbajtur më 11.10.2025, merr këtë:

V E N D I M

REFUZOHET E PABAZUAR ankesa e subjektit politik, Lëvizja Vetëvendosje (LVV), me seli në Prishtinë, ZL.Anr.175/2025, e datës 10.11.2025, paraqitur kundër subjektit Lidhja Demokratike e Kosovës (LDK), për shkak të shkeljes së Kodit të Mirësjelljes për Subjektet Politike, Mbështetësit e tyre dhe Kandidatët, gjatë Fushatës Zgjedhore Zgjedhjet Lokale në Republikën e Kosovës.

A r s y e t i m

Me datë 10.10.2025, PZAP-i ka pranuar një ankesë nga subjekti politik Lëvizja Vetëvendosje (LVV), me të cilën pretendon se më datë 09.10.2025 rreth orës 14:00, aktivistët e Qendrës së Lëvizjes Vetëvendosje, në Prishtinë, kanë vërejtur se Visar Geci këshilltari politik i kandidatit të subjektit LDK për kryetar të Prishtinës, Përparim Rama, në llogarinë personale në facebook ka publikuar një shkrim mesa vijon:

"Ne muajin mars 2024, Komuna e Prishtinës e ka shpalle tenderin për NENKALIM në rrugën Agim Ramadani, në mënyrë që të lidhet sheshi ekzistues me pjesën e vjetër të qytetit për kalimtare (kah Xhamia e Muzeu), përderisa nënkalmi do të shfrytëzohet për tejkalmimin e veturave si pjese e qarkores se brendshme qe kishte me ndihmu me shkarku komplet komunikacionin në qendër". Ne tenderim ky projekt ka dal duke i plotësuar 100% këto kushte ashtu si e përcakton Rregullorja/Ligji. Pas shpalljes se tenderit Hajrulla Çeku e ka pa që Prishtina po don me ndërte nënkalmimin, pas disa muajsh e ka shtu edhe një nen tjeter për me ndalu medeomos këtë projekt, ky asht neni i shtuar 1.8 nën strukturat e tilla si sistemi i kullimit, bodrumet e parkingjeve dhe strukturat ose shërbimet e thella nëntokësore te trashëgimia

arkeologjike, ky nen e ka bllokua komplet projektin! Deri sot ky nënkallim kish përkundu sikur mos te kish blloku!

Për qeta, me ty Hajrullah Çeki s' ka qysh bon njeri as politike as debat normal! Se ti je për prokurori e jo për me llomotit para kamerave, Veç ti qe e urren Prishtinën e s'doni me i pa brezat e ri tuj ec përpara bon k 'ta një qyteti vetëm pse ta mundëson pozita jote zyrtare... duke marr urdhëra nga shoku Mau, i cili ka mu mbajt n'men e ka me u shkru në historinë e Prishtinës për bllokada e shkatërrim tw Kryeqytetit vetëm pse nuk ka mujt vet me menaxhue ata!

Në ankesë theksohet se këto deklarata përbejnë shkelje të nenit 34 të LPZ-së, duke përdorur gjuhë denigruese, fyese dhe banale me c 'rast ka krahasuar kundërshtarët politik me Mao Ce Dunin, i njohur botërisht si komunist kinez, gjuhë kjo që nxit akte dhunë kundër kundërshtarëve politik.

Si provë kanë bashkëngjitur linqet e postimeve në rrjetin social Facebook.

Në përgjigje në ankesë subjekti politik Lidhja Demokratike e Kosovës (LDK) ka theksuar se ankesa është e pabazuar për faktin se Visar Geci nuk është kandidat i certifikuar i këtij subjektit politik për zgjedhjet lokale, dhe njëherë nuk është as anëtar dhe as pjesë e LDK-së. Qëndrimet dhe shkrimet e Visar Geci në rrjetet sociale janë mendime personale dhe nuk përfaqësojnë qëndrim të ndonjë subjekti politik. Nga këto arsye kanë kërkuar që të refuzohet ankesa si e pabazuar.

Paneli pasi që shqyrtoj ankesën vlerësoi se:

-Ankesa është e pabazuar.

Paneli pas shikimit të shkresave të lëndës dhe përgjigjes në ankesë të paraqitur nga subjekti politik, Lidhja Demokratike e Kosovës, vlerësoj se pretendimet e subjektit politik Lëvizja Vetëvendosje, janë të pa qëndrueshme, kjo për faktin se pala ankuese më asnjë provë nuk ka arritur ta argumentoj faktin që Visar Geci është kandidat apo mbështetës i subjektit politik LDK. Paneli ka vlerësuar postimi e marrë nga profili i Visar Geci në rrjetin social Facebook, paraqitur si provë në ankesë, mirëpo nga i njëjti nuk mund të nxjerrët përfundim se Visar Geci është kandidat apo mbështetës i subjektit politik të caktuar, por është shkrim që ka të bëjë me shprehje të mendimit ne lidhje me projekte të caktuara që kanë të bëjnë me Komunën e Prishtinës. Në mungesë të provave konkrete për të dëshmuar që Visar Geci është mbështetës i LDK-së, paneli ka vlerësuar që nuk mund të nxirret përfundimi për shkelje nga neni 34, paragrafi 1.11 të LZP-së.

Meqë provat ekzistuese nuk e ndërlidhin Visar Gecin me subjektin LDK, atëherë PZAP nuk është lëshuar në shqyrtimin e gjuhës së përdorur nga postimi i paraqitur ne profilin tij ne rrjetin social Facebook.

Paneli me rastin e shikimit të shkresave të lëndës, vlerësoi se ankesa është e pabazuar pasi që nga provat e ofruara të cilat parashtruesi i ankesës i ka bashkangjitur në ankesë, nuk mund të vërtetohet se Visar Geci është këshilltar i kandidatit për kryetare Përparim Rama, apo kandidat dhe mbështetës i subjektit politik Lidhja Demokratike e Kosovës.

Duke marrë parasysh të lartpërmendurat, Paneli vlerëson se parashtruesi i ankesës në mbështetje të pretendimeve të tij, nuk ka ofruar dëshmi të qarta dhe bindëse, edhe pse në bazë të nenit 117 paragrafi 3 të LZP-së, barra e të provuarit bie mbi ankuesin, në të cilin nen në mënyrë decisive thuhet se *“Vendosja për ankesat nga PZAP-ja mbështetet në dëshmi të qarta dhe bindëse”*.

Nga arsyet e theksuara më lartë dhe duke u bazuar nënin 117 par. 3, lidhur me nenin 118 pa. 1 të LZP-së, paneli vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtrës
ZL.Anr.175/2025 datë 11.10.2025

Kryesues i Panelit
Kujtim Pasuli



Këshillë Juridike: *Kundër këtij vendimi është e lejuar ankesa sipas nenit 118 paragrafi 4 të LZP-së, në Gjykata Supreme të Kosovë, brenda 48 orëve nga momenti i marrjes-pranimi të këtij vendimi.*